



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0310

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AROMA PLUS SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1, me 14.07.2026 mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjeserisht e bazuar ankesa e OE AROMA PLUS SH.P.K., me nr. 2026/0310, e datës 13.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1.
2. **Vertetohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA E GJAKOVËS, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik AROMA PLUS SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.08.2025 KOMUNA E GJAKOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës B08, për aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 180,000 €.

Me 23.04.2026 KOMUNA E GJAKOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE **Capital X FET SH.P.K.**

Me 28.04.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 04.05.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.05.2026, OE AROMA PLUS SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0310, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AROMA PLUS SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Shkeljet e LPP-se nga ana e Autoritetit Kontraktues	
Neni 1- Qellimi	
Neni 7- Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminim	
Neni 27- Dosja e tenderit	
Neni 28- Specifikimet teknike	
Neni 61- Tenderet Jo-Normalisht të Ulet	

ANKESË

Operatori Ekonomik "AROMA PLUS" SH.P.K., në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, paraqet këtë ankesë pranë Organi Shqyrtues i Prokurimit kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja higjienike e objekteve komunale", me nr. 632-25-7299-2-1-1, si dhe kundër vendimit me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim. Ankesa paraqitet për shkak se vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë në kundërshtim me gjendjen faktike, provat e administruara dhe dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, duke cenuar parimet e trajtimit të barabartë, transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së drejtë.

Pavarësisht argumenteve dhe provave të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar pretendimet tona pa një arsyetim të plotë, objektiv dhe të bazuar në dispozitat ligjore, duke mos adresuar në substancë shkeljet e ngritura.

Vendimi i AK-së është formal dhe nuk përmban arsyetim të mirëfilltë juridik. AK nuk ka trajtuar pretendimet në mënyrë individuale, por ka dhënë përgjigje të përgjithshme, duke mos përmbushur standardin minimal të arsytimit. Kjo bie ndesh me parimet themelore të LPP-së dhe praktikën e OSHP- së, sipas së cilës çdo pretendim duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë dhe të

argumentuar. Ju bashkangjesim Vendimin mbi Refuzimin e kërkeses për rishqyrtim:

VENDIM

1. Refuzohet, si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "AROMA PLUS" SILKe dt.28.04.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale", Nr. i prokurimit-632-23-7299-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-098-211, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 23.04.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me dmë:23.04.2026;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Pretendimi nr 1

AK tek pretendimi nr. I tek mundesit tekniko dhe/ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2 per analizen financiare sipas AK nuk qendron sepse OE I rekomanduar per kontrate, ne te gjitha tabelat ka prezentuar çmimin + TVSH dhe Totali është prezentuar me TVSH. Ne Kerkesen per rishqyrtim ne si OE absolutikisht nuk kemi cekur se analizes financiare në tabelën e prezentuar i mungojnë te dhenat por ne në këtë kërkesë kemi trajtuar dy ceshtje. Ceshtjen e pushimeve vjetore si dhe ceshtjen e materialit. Pra, me pergjegjesi te plote materiale dhe morale e themi se AK manipulon per kete pretendim. Edhe njehere ne vazhdim po e cekim se pretendimi jonë në këtë analizë financiare se OE i rekomanduar për kontrate ka vepruar ne kundershtim me ligjin tek pushimet vjetore si dhe ka vepruar ne kundershtim me kerkese e AK-së per sasin e materialit. Shume shkurt po ua elaborojme edhe njehere ne kete ankese dhe po e sqarojme pushimet vjetore si dhe sasin e materialit. Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 1, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Pretendimi nr 1

Operatori ekonomik CAPITAL X FET i rekomanduar për kontrate është në kundershtim me ligjet e prokutimit. Kërkesa e AK-së tek pika 9.1 dhe 9.2 kërkesat mbi mundësit teknike dhe ose profesionale ka gene (cit): Operatori Ekonomik duhet te deklarohet se punëtorëve se do ti paguan & githë punëtorët paze e nica me punëtorët e këtij sektori me BRUTO prej 400,00€ me të gjitha obligimet ku duhet të llogaritet pushimi vietor sipas Ligiit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës dhe ATK-së Dhe dëshmia (sit); Të dëshmohe me deklarate, origjinale, e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe analizën financiare të detajuar (origjinal).Analizë financiare e vulosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik. Opezateri Ekonomik duhet te derëzei analizën financiare në të cilën përfshihen pagat e punëtorëve për numrin e kërkuar, shpenzimet e materialit dhe të detyrimet tatimore.

Kërkesë e AK-së ka qenë se çdo OE të paraqesë një analizë financiare të detajuar ku pagat për punëtorë duhet të jenë 400 euro BRUTO me të gjitha obligimet ku duhen të llogariten pushimet vjetore sipas Ligiit të punes Nr. 03 L-212 si dhe ligjet e ticta qe rregullojnë marrëdhënien e punës dhe ATK-së. OE duhet të dorëzoj nic analizë financiare në të cilën përfshihen pagat e puntorëve për numrin e kërkuar shpenzimet e materialit dhe detyrimet tatimore. Mirëpo OE i rekomanduar për kontratë tek pushimet. vietore i ka llogaritur në kundërshtim me ligjin. Ai për një muaj ka

llogaritur zëvendësimet e puntorëve për vetëm 61.25 euro pa TVSH kur ti shtohet kësaj shume edhe TVSH-ja është, e barabartë me 72.27 euro. Pastai ne analize financiare eshte kerkuar edhe materiali higienik. OE i rekomandur per kontrate ka llogaritur material per 20 pozicione vetem 67.60 euro pa TVSH, kur ti shtohet dhe TVSH-ja është e barabart me 79.77 euro. Po ua prezantojmë analizën financiare sipas Ligiit me llogaritiet e duhura për 20 puntorë:

Pra, sipas Ligiit per 20 puntorë për pushime vjetore nevojiten per zevendesimin e tyre nevojiten 1.67. Pra, 1.67 puntorë paga mesatare 400 euro Bruto që cahtë e barabartë 400 1.67666.67+ kontributi i punëdhënësit është 20.68 e që është e barabartë 1.67 20.68 = 34.47 e kur të mbledhen te gjitha këto shuma atëherë na jep totalin për zëvendësimet e puntoreve 701.13 euro pa TVSH. Kur ti shtohet edhe 18% TVSH-ja sahte e barabarte me \$27.33 euro. Ndersa. OF I rekomanduar per kontrate per tere xitin sipas analizes se tii financiare ka kalkuluar 735.00 euro per nis vite e as kjo është në kundërshtim me Ligiin nr. 03 L-212. Provë analiza financiare e OF CAPITAL X FET:

Pretendimi nr. 2

Përgjigja e AK-së ndaj pretendimit tonë nr. 2 është e paqartë, jo substanciale dhe nuk adreson fare thelbin e pretendimit ankimor. AK është mjaftuar vetëm me konstatimin se OE i rekomanduar për kontratë, sipas formulës për çmim jo normalisht të ulët, nuk rezulton me çmim jo normalisht të ulët. Një arsyetim i tillë nuk qëndron, pasi pretendimi ynë nuk ka qenë vetëm lidhur me formulën matematikore, por me pamundësinë reale të realizimit të kontratës në përputhje me Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

Ne kemi paraqitur analizë konkrete financiare dhe kemi dëshmuar me çmime reale të tregut se vetëm dy pozicione të kërkuara në FDT tejkalojnë shumën prej 215.33 euro në muaj, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë për të gjitha 20 pozicionet ka ofertuar vetëm 67.60 euro pa TVSH, respektivisht 79.77 euro me TVSH. AK në përgjigjen e saj nuk ka kundërshtuar asnjë nga kalkulimet tona, nuk ka ofruar asnjë analizë financiare dhe nuk ka sqaruar se si me këtë vlerë mund të përmbushen kërkesat obligative të dosjes së tenderit. Prandaj, konsiderojmë se AK ka dështuar të shqyrtojë në mënyrë objektive realizueshmërinë e ofertës dhe OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohej si ofertë e papërgjegjshme dhe në kundërshtim me Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 2, të Kërkesës për Rishqyrtim

Pretendimi nr. 2

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur një tabelë të detajuar me specifikat teknike dhe sasi të mujore për secilin produkt, për secilin objekt përkatës të Komunës së Gjakovës. Për secilin objekt, ndërtesë, drejtori dhe njësi përkatëse. AK ka përcaktuar në mënyrë të qartë, të saktë dhe të detajuar materialet e kërkuara, duke specifikuar llojin dhe sasinë mujore për secilin artikull. si picac e pandashme e dosies së tenderit dhe kërkesave obligative për ofertim. Për qëllime të qartësimit dhe argumentimit të pretendimit tonë, ne do të paraqesim tabelën pikërisht ashtu siç është kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktues, duke iu referuar drejtpërdrejt specifikimeve zyrtare të dosjes së tenderit. Sivas, kësaj table. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar gjithsej 20 lloje të materialeve, të cilat përbëjnë bazën e vlerësimit teknik dhe financiar të ofertave. Për këtë arsye, më poshtë po paraqesim tabelën sipas specifikimeve të përcaktuara në dosien e tenderit. Pra, ne si OE keto çmime te cilat I kemi paraqitur ne kete, table I kemi

siguruar nga kompanite e ndryshme as operojne në Kosove keshtu qe keto çmime jane ekuivalente me çmimet e tregut plus minus 10% me pak ose me shume. Lista e materialit sipas Specifikimeve te Dosics se Tenderit:

1. Tek pozicioni nr. 13 për Kova dhe. Xhokera me 2 sorë për secilin punëtorë që duhen të zëvendsohen
gido 3 muaj 44 copë 6.50 euro (cmimi standart) = 286.00 euro, por pasi qe AK ka paraparë ge keto kova te ndëzoben nicherë në 3 muai brenda xitit on, i bie të ndërtohen. 4 herë atëherë:
 $286 \times 4 = 1144 / 12 = 95.33$ euro ne muai
2. Tek pozicioni nr. 15 për Fabisa elektrike nët gido, kat si dhe objektet e tieza në kuadër të Komunës 18 cope 80.00 euro (cmimi standart) = $1440 / 12 = 120.00$ euro në muaj.

Pra, në bazë të kësaj as e clabuacuum me latte konstatoime se OE I rekomanduar, per kontrat per pastrimin e ketyre siperfaqeve ka parapare xistem 79.77 euro Bruto. Nga kio konstatoime, se AK ne menyxe te kunderlisishme, e ka shpallur fitues ketc. OE dhe ne kundershtrim ne kriteret e DT si dhe me specifikimet teknike te detyrueshme. Sa per informate po e njoftoime AK se vlere e parashikuar per kets kontrat ka gen 180,000.00 keshtu as buxheti ka qenë i mjaftueshem. Atëherë Komisioni i vleresimit menjëherë është duhur, to climngi këtë oferte si të pa përgjiezishme dhe cmimi jo normalisht te ulët. Pra, sa per informate 79.77 euro material nis familic me 5 anctace ne nic baness reth 60 metra katror i shpenzon, ndërsa këtu duhet te pastrohen sipas FDT 13,538 metra katror. OF i rekomandur për kontratë ka llogaritur material për 20 pozicione vetëm 67.60 euro pa TVSH, kur ti shtohet dhe TVSH-ja është e barabartë me 79.77 euro. Provë analiza financiare e OE i rekomanduar per kontrate CAPITAL X FET

Pretendimi nr. 3

Sa i përket pretendimit nr. 3, përgjigja e AK-së është e paplotë, jo substanciale dhe në kundërshtim me obligimin për shqyrtim të plotë të pretendimeve ankimore. AK nuk ka trajtuar fare pretendimet tona konkrete ndaj GOE 1 "INTERNACIONAL GROUP BASE" SH.P.K & "Pro Tech Clean" por është mjaftuar vetëm me konstatimin se nuk do të lëshohet në shqyrtimin e tyre me arsyetimin se i njëjti grup operatorësh është shpallur i pasuksesshem.

Një arsyetim i tillë nuk qëndron, pasi në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi paraqitur shkelje konkrete ligjore dhe materiale, respektivisht se ky OE ka paraqitur kalkulime në kundërshtim me kërkesat ligjore lidhur me pushimet vjetore, si dhe ka ofertuar çmime të parealizueshme për materialet e kërkuara sipas FDT-së. AK nuk ka shqyrtuar asnjë nga këto pretendime, nuk ka dhënë asnjë arsyetim faktik apo ligjor dhe nuk ka kundërshtuar asnjë nga provat e paraqitura nga ana jonë. Prandaj, konsiderojmë se AK ka dështuar të bëjë shqyrtim të plotë dhe objektiv të pretendimit tonë, duke dhënë një përgjigje formale dhe jo meritorie ndaj çështjeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim. Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 3, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Pretendimi

nr.3

Edhe Grupi i Operatoreve Ekonomik "INTERNACIONAL GROUP BASE" SH.PK & "Pro Tech Clean" SH.PK I cili teadeti i tre ka qene i pasukseshem nga Komisioni i Autoritetit Kontraktues. Tek zevendsimet e punctoreys nuk i ka llogatitur pushimet victore konforme Ligiit e Punës. Sipas analizës financiare të këtij GOE pushimet victors i ka llogaritur 715.15 euro BRUTO, ndërsa sinas Ligiit është dashur ti llogarisë, për 20 puntorë për pushime victore nevojiten për

zëvendësimin e tyre, 1.67. Pra, 1.67 PUNTOEË RREA mesatare 400 euro Bruto ge çahetë barabartë 400 1.67-666.67+kontributi i punëdhënësit është 20.68 e oë është e barabartë 1.67 20.68 = 34.47 e kur të mbledhen is gjitha këto shuma atëherë na ise totalin për zëvendësimet e puntoreve 701.13 euro pa TVSH. Kur ti shtohet edhe 18% TVSH-ja është barabarte me 827.33 euro.

Pretendimi

nr.4

Lidhur me pretendimin nr. 4, AK edhe në këtë rast ka dështuar të japë përgjigje konkrete, të arsyetuar dhe të bazuar në faktet e paraqitura në kërkesën tonë për rishqyrtim. Ne kemi argumentuar qartë se edhe GOE INTERNACIONAL GROUP BASE dhe Pro Tech Clean, njëjtë sikurse OE i rekomanduar për kontratë, në analizën financiare të paraqitur ka ofertuar sasi dhe vlera të materialeve që janë në kundërshtim të plotë me Specifikimet Teknike të Detyrueshme të përcaktuara nga vetë AK në dosjen e tenderit. Nga analiza financiare rezulton se ky GOE ka llogaritur vlerën mujore të materialit në shumën prej vetëm 67.87 euro, vlerë kjo që është ekonomikisht e përealizueshme dhe në disproporcion të plotë me kërkesat e FDT-së për furnizimin me materiale në 20 pozicione obligative për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit. AK në përgjigjen e saj nuk ka kundërshtuar asnjë nga kalkulimet tona, nuk ka bërë asnjë analizë financiare, nuk ka dhënë asnjë arsyetim profesional dhe nuk ka sqaruar se si me këtë vlerë mund të përmbushen kërkesat teknike të dosjes së tenderit. Për rrjedhojë, konsiderojmë se AK nuk ka bërë vlerësim objektiv dhe material të ofertës së këtij GOE, ndërsa e njëjta është dashur të vlerësohej si ofertë e papërgjegjshme, e përealizueshme dhe në kundërshtim me Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 4, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Pretendimi nr.4

Edhe ky GOE ashtu siq edhe Operatori i parë tek materiali ka llogaritur 67.87 euro material higienik per pastrim me TVSH. Pra, pasi e claburuam me larte po konstatojme se nuk ka nevojte te perseriten edhe nishers gjerat, Prove analiza financiare e INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K:

Pretendimi nr.5

Sa i përket pretendimit nr. 5, AK edhe në këtë rast nuk ka bërë shqyrtim meritore të pretendimeve tona, por është mjaftuar me një përgjigje formale duke deklaruar se nuk do të lëshohet në shqyrtimin e ofertës së GOE Krasniqi SH.P.K dhe Allton SH.P.K, me arsyetimin se i njëjti është shpallur si i pasuksesshëm. Një arsyetim i tillë nuk qëndron dhe nuk e liron AK nga obligimi ligjor për të trajtuar dhe arsyetuar secilin pretendim ankimor të paraqitur nga OE. Në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi argumentuar me prova konkrete se edhe ky GOE, në analizën financiare të paraqitur, tek pozicionet e materialit ka ofertuar shumën prej vetëm 986.11 euro, vlerë kjo që nuk është në përputhje me sasinë, llojin dhe kërkesat obligative të përcaktuara në Specifikimet Teknike të Detyrueshme të dosjes së tenderit. AK nuk ka trajtuar asnjë nga kalkulimet dhe provat tona, nuk ka dhënë asnjë analizë financiare apo arsyetim profesional lidhur me realizueshmërinë e kësaj oferte dhe nuk ka kundërshtuar asnjë nga faktet e paraqitura nga ana jonë. Për rrjedhojë, konsiderojmë se edhe në këtë pretendim AK ka dështuar të bëjë shqyrtim të plotë, objektiv dhe të arsyetuar të pretendimeve tona, duke dhënë një përgjigje formale dhe jo meritorë, në kundërshtim me parimet e trajtimit të drejtë dhe vlerësimit objektiv të ofertave. Të

bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 5, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Pretendimi nr. 5
Edhe GOE Krasniqi SH.P.K & Allton SH.PK i sili tenderi i tyre ka qene i pasukseshëm nga Komisioni i Autoritetit Kontraktues. Tek pozicioni i materialit ka dhënë çmim jo normalisht të ulët në krahasim me anecifikat e DT. Ky GOE ka paraparë per pastrimin e ketyre siperfaqeve 986.11 euro gjë që nuk është skuivalent me sasinë e materialit e cila është kerkuar. Provë analiza financiare e GOE Krasniqi SH.P.K & Allton SH.PK

Pretendimi nr. 6
AK në këtë rast nuk ka trajtuar fare përmbajtjen e pretendimit tonë ankimor, por është kufizuar vetëm në faktin se GOE Erik SH.P.K dhe Schafberger Jr. GmbH është eliminuar për shkak të mosvazhdimet të validitetit të ofertës.

Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik "AROMA PLUS" SH.P.K., më datë 28.04.2026, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja higjienike e objekteve komunale", me nr. të prokurimit 632-23-7299-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 632-25-098-211.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, me datë 04.05.2026, ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka dhënë këtë përgjigje:

Lidhur me pretendimin tuaj që ka të bëjë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas pikave 9.1 dhe 9.2, përkatësisht analizën financiare, Autoriteti Kontraktues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në të gjithë tabelorët ka prezantuar çmimin me TVSH dhe totali i ofertës është paraqitur gjithashtu me TVSH.

Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me specifikimet teknike të detyrueshme, Autoriteti Kontraktues konsideron se edhe ky pretendim është i pabazuar, pasi, bazuar në formulën për vlerësimin e çmimeve, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur çmim jonormalisht të ulët.

Sa u përket pretendimeve tuaja ndaj Grupit të Operatorëve Ekonomikë "INTERNACIONAL GROUP BASE" SH.P.K. dhe "Pro Tech Clean" SH.P.K., Autoriteti Kontraktues nuk është lëshuar në shqyrtimin e tyre, me arsyetimin se ky grup operatorësh ekonomikë është shpallur i pasuksesshëm në procedurën e prokurimit.

Po ashtu, edhe pretendimet tuaja ndaj Grupit të Operatorëve Ekonomikë "KRASNIQI" SH.P.K. dhe "ALLTON" SH.P.K. nuk janë shqyrtuar, pasi edhe ky grup është shpallur i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Ndërkaq, Grupi i Operatorëve Ekonomikë "ERIK" SH.P.K. dhe "Schafberger Jr. GmbH – Dega Kosovë" është eliminuar nga procedura e prokurimit për shkak se nuk ka zgjatur validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit. Për këtë arsye, ky operator ekonomik konsiderohet jashtë garës dhe, rrjedhimisht, pretendimet tuaja në lidhje me të nuk janë shqyrtuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.05.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0310, ndërsa me datë

02.06.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0310, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar pjesërisht lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AROMA PLUS SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0310 ka vlerësuar si në vijim:

Aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirembajtja higjienike e objekteve Komunale”** me nr. të prokurimit: "632-25-7299-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E GJAKOVËS**, procedurë e hapur, lloji i kontratës shërbim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Njoftimit B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

OE ankues është shpallë i pasuksesshëm.

OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron pretendime ankimore kundër vlerësimit të AK-së.

Në ankesë i njëjti pretendon se AK gjatë vlerësimit të ofertave shkelë Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) përkatësisht nënenet: 1,7,27,28 dhe nenin 61. Duke parashtruar pretendime ankimore kundër OE të rekomanduar si dhe kundër operatorëve të tjerë në procedurë.

(Shënim: Pretendimet ankimore gjenden të përshkruara lartë në raport tek pjesa Dispozitat e Shkelura dhe Pretendimet Ankimore)

Pretendimi i parë i OE ankues kundër OE të rekomanduar për kontratë

OE ankues në ankesë lidhur me OE të rekomanduarin pretendon se nuk i plotëson kërkesat dhe se është i papërgjegjshëm, për arsye se, sipas analizës financiare nuk ka llogaritur sakt shpenzimet, zëvendësimet, materialin harxhues, andaj edhe ka ofertën më të lirë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër OE të rekomanduar për kontratë

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në dosje të tenderit (DT) si kërkesë mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale ka kërkuar:

Kërkesa:

Operatori Ekonomik duhet të deklarohej se punëtorëve se do ti paguan të gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori me BRUTO prej 400,00€ me të gjitha obligimet ku duhet të llogaritet pushimi vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës dhe ATK-së.

Dëshmia e kërkuar:

Të dëshmohet me deklaratë origjinale e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe analizën financiare të detajuar (origjinal).

Kërkesa:

Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë analizën financiare në të cilën përfshihen pagat e punëtorëve për numrin e kërkuar, shpenzimet e materialit dhe të detyrimet tatimore.

Dëshmia e kërkuar:

Analizë financiare e vulosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik.

Kërkesa:

Operatori Ekonomik duhet të deklarohej se pagat e punëtorëve do të paguaj për muajin paraprak, me sa largu deri me datë 05 të muajit në vijim, pa marrë parasysh pagesën e bërë nga Autoriteti Kontraktues.

Dëshmia e kërkuar:

Deklarata origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.

Në ofertën e OE të rekomanduar gjendet Analiza Financiare në të cilën janë kalkuluar: Pagat, zëvendësimet, materiali higjienik, totali pa TVSH dhe me TVSH, i cili kalkulim është bërë për një muaj si dhe për 12 Muaj si total i ofertës.

OE ankues në ankesë pretendon se i njëjti nuk ka kalkuluar sakt pushimet dhe zëvendësimet e punëtorëve, materialin higjienik është llogaritur pa TVSH, e cila nëse i shtohet TVSH rezulton më tepër, andaj sipas llogaritjeve pretendohet se gjithashtu posedon çmim/ ofertë jo normalisht të ulët.

Ekspertja tutje shpjegon, krahas kërkesës së AK-së në DT me analizën e ofruar nga OE i rekomanduar, rezulton se në analizë është e përfshirë kërkesa e DT-së, paga bruto 400 euro sipas Ligjit të punës, ka përshkruar po ashtu një llogaritje për materialin harxhues higjienik 811.17 euro për 12 muaj, zëvendësimet dhe TVSH totale.

I cili kalkulim sipas kërkesës në DT, është kërkuar paga bruto 400 euro sipas Ligjit të punës, pra në analizë kërkohet që të kalkulohej paga, rrjedhimisht është respektuar paga 400 bruto, **janë të përfshirë 21 punëtor** të inkuadruar edhe menaxherin. **Pretendimi i OE ankues gjendet**

pjesërisht i qëndrueshëm, për faktin se kërkesa e AK-së për pagën bruto 400 euro, është kërkuar të respektohet Ligji i Punës, që nënkupton pushimet dhe benefitet janë të përfshira në kontratë në kuadër të pagës, TVSH mund të llogaritet ose në çdo kalkulim, por mundet edhe në total, i cili kalkulim jep të njëjtën vlerë (TVSH 18%), tek zëvendësimet analizuar të gjitha kalkulime financiare të ofertuesve në procedurë, rezulton se, disa kanë kalkuluar për 20 ditë pune, disa për 22 ditë pune, prandaj evidentohet dallimi në kalkulim.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues lidhur me materialin harxhues të kalkuluar në Analizën financiare.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, AK në FDT përpos kërkesave të specifikuara më lartë, në vazhdimësi bashkangjet një tabelë e cila sipas Ankes 1 Specifikimet teknike të detyrueshme, pika 4 citat:

4. Që në baza të rregullta mujore, të bëjë furnizimin me material higjienik sipas specifikacioneve dhe sasisë të precizuar (gjeni të bashkëngjitur);

Në Tabelë janë të specifikuara sasisë e kërkuara mujore sipas objekteve të përfshira:

Tutje, nga tabela e paraqitur në DT rezulton se, kërkesa e AK-së është mirëmbajtja higjienike e 10 objekteve komunale për periudhën 1 vjeqare. Sasisë e materialit harxhues higjienik për cdo objekt parashikohen në total, psh vetëm Detergjent për dysheme 1 litër për 10 objektet rreth 121 copa, pastaj detergjenti për banjo (psh. Domestos) 1 litër rreth 115 copa, etj etj, **këto sasi sipas tabelës janë të përfshira sasi në baza mujore, produktet për secilin objekt përkatës.**

Në të njëjtën kohë, lidhur më këtë tabelë dhe vlerën e parashikuar, ekspertja shqyrtuese në mënyrë që të jetë sa më objektive, ka kërkuar sqarim me e-mail nga AK me datë 29/05/2026 citat:

Të nderuar,

Jemi në shqyrtim të lëndës me numër 310/2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale” nr. 632-25-7299-2-1-1.

OE ankues ka parashtruar pretendime ankimore kundër operatorëve ekonomikë në procedurë, i cili pretendon se analizat financiare nuk janë të kalkuluara saktë.

Pas analizimit të shkresave të lëndës, në dosje të tenderit tek Aneksi 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme si dhe Tabela e bashkëngjitur si parashikim mujor, kërkojmë që të sqaroni dhe të na ofroni analizën e bërë konform vlerës së parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Ju lutem na sqaroni në detaje këtë planifikim sipas vlerës së parashikuar.

Shpresojmë në përgjigje të shpejtë.

Ju faleminderit paraprakisht për bashkëpunim.

Me respect,

Mirëpo, AK meqë ende nuk ka ofruar sqarim, marrë parasysh afatin ligjor për raport të ekspertizës, atëherë si e tillë është vazhduar pa përgjigje të AK-së.

Andaj bazuar në tabelën e bashkangjitur më lartë e cila është pjesë e Ankes 1 në DT nënkupton:

Nëse kalkulojmë vetëm artikulli i parë Detergjent për dysHEME sasia e kërkuar për 10 objektet për muaj është 121 copa, dhe nëse kalkullohet me një çmim minimal 1 euro= 121 euro në muaj vetëm artikulli i parë.... x 12 Muaj = 1452 euro.

Nga AK është kërkuar që të ofrohet analiza financiare duke përfshirë pagat, materialin hargjues dhe detyrimet tatimore, për të cilat OE i rekomanduar në analizë ka shtuar materialin për shumën në muaj 67.60 euro dhe për 12 muaj total 811.17 euro.

Sipas kalkulimit më të thjeshtë me çmim minimal, bazuar edhe në argumentet e OE ankues në ankesë, ky kalkulim 67.60 euro në muaj për material harxhues, është shumë i ulët, i cili shpenzim të asocion me mungesë materiali në realizim të kontratës. (Siç ndodhë në shumë institucione, që në objekt nuk ka shampoon, letër etj...). **Andaj pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër Grupit OE” International Group Base” SHPK

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se, Grupit OE” International Group Base” SHPK është shpallë i pasuksesshëm, për të cilin OE ankues posedon po të njëjtat pretendime sikur tek OE i rekomanduar: paga, materiali harxhues si analizë financiare dhe oferta në tërësi.

Rrjedhimisht bazuar në shkresat e lëndës, në ofertën e GOE ” International Group Base” SHPK gjendet analiza në të cilën është kalkuluar paga bruto 400 euro konform kërkesës në DT, ndërsa materiali harxhues është ofruara 67.87 euro për muaj, dhe si e tillë, **pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm** për arsye së, bazuar në Ankes 1 të DT-së nëse kalkulojmë **vetëm artikulli i parë** Detergjent për dysHEME sasia e kërkuar për 10 objektet për muaj është 121 copa, ndërsa OE në fjalë në total për një muaj për tërë materialin harxhues në analizë është kalkuluar 67.87 euro.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër Grupit OE”Krasniqi SHPK & Alltonë SHPK”

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se, Grupi OE **Krasniqi SHPK & Alltonë SHPK** është shpallë i pasuksesshëm, për të cilin OE ankues pretendon se tek materiali harxhues ka dhënë çmimin 986.11 euro për 12 muaj, si çmim jo normalisht i ulët.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës, në ofertën e GOE në fjalë gjendet analiza financiare, i cili për materialin harxhues higjienik kalkulon 986.11 euro në vit dhe nëse përpjestohet në muaj i bie 82.17 euro, e cila vlerë bazuar në dy operatorët e tjerë, ky kalkulim është pak më i lartë, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht u bazuar për faktin se AK gjatë rivlerësimit të analizoj kalkulimet krahas parashikimeve dhe çmimeve të tregut.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues kundër Grupit OE “Erik SHPK & Achafberger Jr. GmbH”

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se, Grupit OE “Erik SHPK & Achafberger Jr. GmbH” është shpallë i eliminuar me arsyetimin se nuk ka

vazhduar validitetin e ofertës, për të cilin OE ankues pretendon se AK nuk është përgjigjur në pretendimet ankimore kundër OE në fjalë.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës, GOE në fjalë meqë është i eliminuar për mos vazhdim të validitetit, si e tillë nuk mund të ndyshoj vlerësimin. Andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Si përfundim: Aktiviteti i prokurimit ka nisur me publikimin e Njoftimit për kontratë më datë **25/09/2025**. Më pas, Dosja e korrigjuar është publikuar më **03/12/2025**, ndërsa hapja e ofertave është realizuar më **09/12/2025**. Raporti final i vlerësimit nga komisioni është publikuar më **22/04/2026**, dhe Njoftimi B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktor është shpallur më **23/04/2026**.

Duke analizuar kohën e kaluar nga publikimi i njoftimit për kontratë deri te vendimi përfundimtar i AK-së, si dhe duke marrë parasysh ndryshimet e paralajmëruara nga Ministria e Financave për rritjen e pagës minimale në **500 euro**, rekomandohet që AK në rivlerësim të kryejë një **analizë financiare të brendshme** lidhur me vlerën e parashikuar dhe Aneksin 1 mbi materialin harxhues.

Kjo është e nevojshme për shkak se kriteri i çmimit më të ulët të përgjegjshëm nuk garanton gjithmonë realizim të mirëfilltë të kontratës, duke rrezikuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e saj.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashitësit dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/saj, se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor sa i perket analizes financiare te OE te rekomanduar , PSH nuk e mbeshtet raportin e ekspertit shqyrtues keshtu vlereson se raporti i ekspertit shqyrtues ka tejkaluar kufijtë e kërkesave të përcaktuara në DT dhe keto vleresime te paraqitura ne raport jane bërë vlerësime te paraqitura dhe jo te bazuara në kërkesat konkrete të DT. PSH bazuar ne DT kosntaton se si kërkesë mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale AK ka kërkuar: Kërkesa: *“Operatori Ekonomik duhet te deklarohet se punëtorëve se do ti paguan të gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori me BRUTO prej 400,00€ me të gjitha obligimet ku duhet të llogaritet pushimi vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës dhe ATK-së”*.Dëshmia e kërkuar: *“Të dëshmohet me deklaratë origjinale e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe analizën financiare të detajuar (origjinal)”*. Kërkesa: *“Operatori Ekonomik duhet te dorëzoj analizën financiare në të cilën përfshihen pagat e punëtorëve për numrin e kërkuar, shpenzimet e materialit dhe të detyrimet tatimore”*.Dëshmia e kërkuar: *“Analizë financiare e vulosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik”*.Kërkesa: *“Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se pagat e punëtorëve do te paguaj për muajin paraprak, me sa largu deri me date 05 te muajit ne vijim, pa marr parasysh*

pagesën e bërë nga Autoriteti Kontraktues”.Dëshmia e kërkuar: “Deklarata origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik”.

PSH vlereson se nga dokumentacioni i ofertës rezulton se OE i rekomanduar ka dorëzuar të gjitha deklaratat e kërkuara dhe analizën financiare të nënshkruar e vulosur, duke përfshirë pagat, zëvendësimet, materialin higjienik dhe TVSH-në.Asnjë dispozitë e Dosjes së Tenderit nuk ka përcaktuar ose kërkuar ,psh si: vlerë minimale për materialin harxhues; çmime referente për secilin artikull; metodë të detyrueshme të kalkulimit ose edhe obligim që secili artikull të kalkulohej sipas një çmimi minimal të caktuar. Rrjedhimisht konstatimi ne raportin e ekspertizes se shuma prej 67.60 euro në muaj është "shumë e ulët" nuk mbështetet në ndonjë kërkesë të Dosjes së Tenderit.

Sa i perketë kalkulimit me material shpenzues PSH nuk e mbështetë pergjigjen ne raport te ekspertizes pasi qe mendimi përfundimtar duke marrë vetëm artikullin "Detergjent për dysheme", duke supozuar se secila njësi duhet të kushtojë të paktën 1 euro dhe prej kësaj ka ardhur ne përfundimin se analiza financiare është e pasaktë, PSH konsideron se një metodologji e tillë nuk mund të përdoret si bazë për eliminimin nga kjo procedure per nje OE për arsyet se : DT nuk ka përcaktuar çmime minimale për artikujt po ashtu nuk eshte bere ndonje analizë e detajuar e tregut që të provojë se çmimi minimal është 1 euro.

Ndersa sa i perketë ofertes lidhur me çmime jonormalisht te ulët, po ashtu PSH nuk e mbështetë raportin e ekspertës ku ne disa pjesë të raportit potecon se oferta mund të jetë jonormalisht e ulët, pershkak se nuk eshte zhvilluar procedura e parapare sipas dispozitave ligjore te nenit 61 te LPP-se gje qe PSH konsideron se nuk mund të arrihet në përfundim se oferta është jonormalisht e ulët vetëm mbi bazën e një kalkulimi te pa argumentuar me prova faktike.

Lidhur me pretendimin ankimor sa i perketë operatoreve tjere ekonomik, PSH po ashtu nuk e mbështetë raportin e ekspertit i cili ka konsideruar se vlera e materialit harxhues është i ulët , keshtu PSH edhe këto konstatime i vlereson se nuk jane marre per baze kerkesat e vendosura ne DT dhe te nejtat nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për cenimin e vlefshmërisë së ofertave.

PSH sa i perketë mendimit te dhene ne raportin e ekspertit qe rekomandon rivlerësim duke u mbështetur edhe në faktin se pas zhvillimit të procedurës është paralajmëruar rritja e pagës minimale në 500 euro. Paneli konsideron se ky argument është juridikisht i parëndësishëm për këtë procedurë.Ligjshmëria e një procedure të prokurimit vlerësohet sipas legjislacionit dhe kerkesave te parashtruara ne DT që kanë qenë në fuqi në momentin e zhvillimit të procedurës dhe dorëzimit të ofertave. Ndryshimet eventuale të ardhshme në legjislacion apo në nivelin e pagës minimale nuk mund të përdoren si bazë për rivlerësimin ose anulimin e një procedure të zhvilluar.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet por vetëm si pjesërisht e bazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale me numër të prokurimit 632-25-7299-2-1-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk

ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " AROMA PLUS " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: